



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E ANKANDIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2021

SHTOJCË MBI MODIFIKIMIN DHE NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE
STANDARTE TË ANKANDIT

Sot më datë 20/04/2021, Njësia e Ankandit e ngritur me urdhërin e titullarit të Bashkisë Shkodër nr.54, datë 22.01.2021 “Për krijimin e njësisë së ankandit me objekt: “Shitje me ankand e aksioneve të klubit të futbollit “Vllaznia” sh.a në masen 100%”, e përbërë nga kryetar z.Ardit Çylybyli, anetarët znj.Vinifreda Gazulli, znj.Manjola Fushaxhia, z.Aldi Topciu, z.Kristaq Ndini :

Në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me nr.164/2021.prot, dt. 13.04.2021, pas ankesës së një kandidati ofertues/blerës për procedurën e ankandit publik me objekt: Bashkia Shkodër shet me ankand aksionet e Klubit të Futbollit “VLLAZNIA”SH.A në masën 100%, me vlerë fillestare 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë, Njësia e Ankandit vendosi të bëjë ndryshimet përkatëse në Dokumentat Standarte të Ankandit në zbatim të këtij vendimi, si më poshtë vijon:

ISHTE

Kriteret e Veçanta të Kualifikimi, shtojca 5.2:

u) Sponsorizime të ngjashme në një vlerë prej 20,317,600 lekë (40% e vlerës fillestare të ankandit), të realizuara. Çdo sponsorizim rregullohet me kontratë të lidhur ndërmjet sponsorizuesit dhe përfituesit. Kryerja e çdo sponsorizimi, në para a në natyrë, dokumentohet në pajtim me legjislacionin tatimor kontabël e bankar në fuqi. Si dëshmi për përvojën e mëparshme subjekti/tet të paraqesë dokumenta që vërtetojnë:

Sponsorizimet në favor të sporteve ekipore më të përhapura, të destinuara për:

1. evidentimin e talenteve dhe zhvillimin e sportistëve të rinj;
2. mbulimin e shpenzimeve të stafit sportiv;
3. përmirësimin dhe rinovimin e pasurive të luajtshme që i shërbejnë për aktivitetin sportiv;
4. zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës sportive;
5. shpenzimet që kanë të bëjnë me trajnimin; ose
6. mbulimin e shpenzimeve që rrjedhin nga organizimi i garave sportive.

Dokumentat që vërtetojnë transferimin e shumës së sponsorizimit, do të jenë, aktmarrëveshje, vendime të këshillit bashkiak për donacione apo sponsorizime, dokumente bankare që vërtetojnë transferimin e shumave, fatura tatimore, akte dhurimi, proces verbale marrje në dorëzim, fletë hyrje, etj dokumenta që parashikohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë tatimor kontabël e bankar në fuqi.

BËHET

Ky kriter hiqet.

ISHTE

Për të vërtetuar se kandidati blerës është i kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë:

- q) Kontrata, transaksione dhe eksperiencia në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit apo edhe për sporte të ngjashme, minimalisht në tre vitet e fundit, pjesë të veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB.

BËHET

Për të vërtetuar se kandidati blerës është i kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë:

- q) Kontrata, transaksione dhe eksperiencia në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive, shoqërive sportive, pjesë të veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB.

Të gjithë kandidatëve ofertues së bashku me shtojcën për modifikimin dhe ndryshimin e kriterëve, ju vihet në dispozicion informacioni i plotëshkresor dhe gjithë dokumentacioni mbi gjendjen financiare të Shoqërisë, të drejtat dhe detyrimet që Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a. ka ndaj të tretëve, në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.164/2021 pika III.4.3 dhe III.5.1.

Informacioni i plotë shkresor dhe gjithë dokumentacioni mbi gjendjen financiare të Shoqërisë Klubi i Futbollit “Vllaznia” është bashkëlidhur sipas listimit më poshtë:

- Pasqyra financiare, bilanci viti 2020 .
- Pasqyra financiare, bilanci viti 2021 T-1.

Sa më sipër Njësia e Ankandit në mbështetje të nenit 43/2 pika 2 ligjit nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin Publik”, të ndryshuar, VKM 1719, datë 17.12.2008 " Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.164/2021 vendos të bëjë modifikimet në dokumentet e procedurës së ankandit, në përputhje me Konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik.

NJËSIA E ANKANDIT

z.Ardit Çylybyli	kryetar
znj.Vinifreda Gazulli	anetare
znj.Manjola Fushaxhia	anetare
z.Aldi Topciu	anetarë
z.Kristaq Ndini	anetarë